


## Projekti “Nxitja e Lëvizjes për Ujin dhe Pyjet në Ballkan”



## **Balkan GEM –Projekti “Nxitja e Lëvizjes për Ujin dhe Pyjet në Ballkan”**

Partneri Drejtues: Instituti i Kërkimit për Ekologjinë Pyjore dhe Pyjet (FAWF), Projekte Ndërkombëtare dhe Rrjetëzimi, Trippstadt, Gjermani

Coordinator Projekti: CNVP – Fondacioni Lidhja e Vlerave të Natyrës me Njerëzit (CNVP)

Partnerët: Pyjet Kombëtare, Maqedonia e Veriut; Ndërmarrja Shtetërore, Serbi; Mnistria e Turizmit dhe Mjedisit, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Shqipëri

### **Objektivat e Projektit**

Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia dhe Shqipëria përballen me një seri sfidash përse i përket çështjeve të lidhura ngushtësisht me menaxhimin e pyjeve dhe ujrave. Në këto vende probleme të tilla është e nevojshme të trajtohen në mënyrë të përbashkët nga menaxhuesit e pyjeve dhe ujrave përmes një potenciali për bashkërendim ndërmjet administrimit të pyjeve dhe ujrave duke përfshirë këtu edhe aktorët e interesuar.

Planifikimi në sektorin e Pyjeve në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Serbi do të përfshijë aspekte lidhur me menaxhimin e ujit me qëllim që të ofrohen shërbime të përmirësuara në ekosistemet përreth burimeve ujore.

Objektivi i parë specifik është zhvillimi i masave model për mbrojtjen e ujit në zonat pyjore përmes një menaxhimi të integruar të pyjeve dhe ujrave në kuadër të planifikimit në pyje.

Objektivi i dytë specifik, kapacitetet për planifikimin pyjor në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Serbi duhet të zgjerohen më tej përmes një strategjie integruese të menaxhimit të pyjeve me fokus të veçantë në ruajtjen e ujit në zonat pyjore.



Kriteri Pan European për menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve (MQP) kriteret dhe indikatorët janë parashtruar në Helsinki në vitin 1993, Resolution H1

## PJESA E I: UDHEZIME TE PERGJITHESHME

6. Praktikrat e Menaxhimit të Pyjeve duhet të përmbajnë respektin e duhur për mbrojtjen e zonave të brishta ekologjike, me konservimin e pyjeve kryesorë dhe të zhvilluar; zonave me trashëgimni kulturore, dhe pejsazh, **për të ruajtur sasinë dhe cilësinë e ujit**, si dhe për të mbajtur dhe zhvilluar më tej funksine të tjerë mbrojtës të pyjeve të tillë si **mbrojtja e ekosistemeve ujore dhe bujqësore si dhe mbrojtja ndaj përmytjeve, erozionit dhe orteqeve**.

Praktikat e menaxhimit të pyjeve duhet të synojnë në ruajtjen dhe nëse është e mundur përmirësimin e stabilitetit, vitalitetit, kapacitetit rigjenerues, kapacitetit rezistues dhe adoptues të ekosistemeve ndaj streseve përfshirë këtu zjarret, dëmtuesit, sëmundjet, gjahun dhe agjentë të tjerë dëmtues sikurse mbi kullotja dhe kullotja e pa organizuar. Është e rëndësishme të mbështetet parandalimi dhe kontrolli i dëmeve të mëdha shkaktuar nga gjallesat (organizmat biotikë) ose nga jo gjallesat (abiotikë). **Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar ruajtjes dhe nëse është e nevojshme përmirësimit të cilësisë së tokave pyjore**. Gjithashtu duhen inkurajuar praktikrat silvikulturore që çojnë drejt rivitalizimit të natyrës. Ndërsa praktikrat që bien ndesh menaxhimit të qëndrueshëm duhet në mënyrë aktive të mos mbështeten.

## PJESA II: VEPRIME NE TE ARDHMEN

13. **Vendet nënshkruese** dhe Bashkimi European angazhohen në **përgatitjen pa vonesë të udhëzuesve specifikë kombëtarë apo rajonalë dhe përfshirjen e tyre në planet dhe programet mbi pyjet për zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithëshme të cituara më lart**, në mënyrë të përputhur me deklaratimet mbi Parimet e Pyjeve, dhe do të bashkëpunojnë në zhvillimin e mëtejshëm të këtyre Udhëzuesve të përgjithshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në Europë.

## ANEKSI 2 I REZOLUTES L2, Pan-Europiane Udhëzime në Nivel Operacional për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve

Udhëzuesit në Nivel Operacional krijojnë një kuadër të përbashkët rekomandimesh që mund të përdoren mbi baza vullnetare dhe si përplotësues të instrumentave komëbtarë dhe/ose rajonalë për promovim të mëtejshëm të menaxhimit të pyjeve në terren, në zonat pyjore të Europës.

Adoptuar në Takimin e Pestë Përgatitor të Ekspertëve në Konferencën e Lisbonës mbi mbrojtjen e Pyjeve në Europë, 27-29 Prill 1998, Gjenevë, Zvicër.

Udhëzuesit Pan-European në Nivel Operacional janë zhvilluar më tej për një promovim të suksesshëm të menaxhimit të pyjeve në Europë duke i përkthyer angazhimet ndërkombëtare në nivelin praktik të menaxhimit dhe planifikimit të pyjeve. Ato përfaqësojnë një kuadër të përbashkët rekomandimesh për t'ju referuar në terren duke i përdorur mbi baza vullnetare.

## **KRITERI 5. Ruajtja dhe Pasurimi i Mëtejshëm i funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (me fokus tokën dhe ujin)**

### **5.1 Udhëzime mbi Planifikimin e Menaxhimit të Pyjeve**

- a. Planifikimi i Menaxhimit të Pyjeve duhet të synojë në ruajtjen dhe pasurimin e mëtejshëm të funksioneve mbrojtëse të pyllit për shoqërinë, të tillë si mbrojtja e infrastrukturës, mbrojtja nga erozioni i tokës, mbrojtja e burimeve ujore si dhe nga ndikimet negative të ujit të tilla si përmbytjet apo orteqet.
- b. Zonat që përmbushin funksione mbrojtëse specifike dhe të njohura për shoqërinë duhet të rregjistrohen dhe pasqyrohen në harta, ndërsa planet e menaxhimit të pyjeve apo equivalentët e tyre duhet të marrin tërësisht në konsideratë zona të tilla.

### **5.2 Udhëzime për Praktikën e Menaxhimit të Pyjeve**

- a. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar operacioneve silvikulturore në toka të ndjeshme, në zona që preken nga erozioni si dhe në zonat ku operacionet mund të çojnë në shkallë të rëndë të erodimit të tokës drejt rrjedhave ujore. Në këto zona duhet të shmangen teknikat e pa përshtatëshme të tilla si plugimi i thellë i tokës dhe përdorimi i makinerive të pa përshtatëshme. Gjithashtu duhen ndërmarrë masa të veçanta për të zbutur presionin e popullacionit të kafshëve mbi pyjet.
- b. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar praktikave të menaxhimit të pyjeve në zonat pyjore me funksion mbrojtjen e ujit për të shmangur efektet negative mbi sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore. Gjithashtu duhet shmangur përdorimi i pa përshtatëshëm i kimikateve apo substancave të tjera të dëmshme si dhe i praktikave të pa përshtatëshme silvikulturore që ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ujit.
- c. Nëndrtimi i rrugëve, urave dhe infrastrukturës tjetër duhet të kryhet në mënyrë të atillë që të minimizojë ekspozimin e tokës së zhveshur, të shmangë rrëshqitjen e tokës drejt rrjedhave ujore si dhe të mbrojë nivelin natyror të funksionit të rrjedhave ujore dhe shtrateve të lumenjve. Gjithashtu duhen krijuar dhe mirëmbajtur praktika që sigurojnë drenazhimin e duhur të rrugëve.

## Treguesit e azhornuar, Madrid 2015

Sipërfaqja pyjore dhe zona të tjera me drurë pyjor të përcaktuar për të mbrojtur tokën nga erozioni, për të mbrojtur burimet ujore, ruajtur funksione të tjera mbrojtëse, mbrojtur infrastrukturën dhe **menaxhuar burimet natyrore ndaj rreziqeve natyrore.**

**A ekzitojnë kritere dhe indikatorë të pranuar në Shqipëri në nivel kombëtar?**

**Donator**



**Partneri Kryesor**



**Koordinator Projekti**



**Partnerët**

